



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 20, Datë 19.01.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A,
PËR VITIN 2018.**

Në mbështetje të neneve 13 pika 2, 17 pika 1, gërma “e”, dhe 33 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe nenit 19 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me miratimin e t arifës së shoqërisë Albgaz sh.a si operator i transmetimit të gazit natyror, për vitin 2018,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 85/1 Prot., datë 03.01.2018, (protokolluar në ERE me nr. 13 Prot., datë 04.01.2018), Albgaz sh.a, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017 ka Certifikuar shoqërinë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, Albgaz” sh.a.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, ka licencuar shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të gazit natyror.
- Me vendimin, nr. 90, datë 07.06.2017, Bordi i ERE ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”.
- Me vendimin nr. 155, datë 28.09.2017 të Bordit të ERE është vendosur mbi Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017–20.09.2017” deri në 31.12.2017.

- Bordi i ERE me vendimin nr. 178, datë 08.11.2017, ka miratuar Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- Me vendimin e Bordit të ERE nr. 14 datë 10.01.2018, është vendosur për shtyrjen e afatit të tarifës së përkohëshme të transmetimit për shoqërinë Albgaz miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 90, datë 07.06.2017, deri në datë 31.03.2018.
- Nuk është respektuar afati i aplikimit në zbatim të nenit 21, pika 3 të “*Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*” miratuar me Vendimin Nr.178, datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s.
- Aplikimi duhet të shoqërohet me analiza dhe argumenta për të gjitha shpenzimet operative të vitit ushtrimor të mbyllur duke dërguar në ERE pasqyrat financiare paraprake për vitin 2017.
- Mungojnë argumentat dhe analiza e detajuara mbi nivelin e propozuar për të gjithë elementët përbërës të kostove operative konform nenit 7 dhe nenit 8 të *Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*, për periudhën e ardhshme 2018.
- Aplikimi duhet të plotësohet me analizat e llogaritjeve të Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) për vitin 2017 për të evidentuar dhe paraqitur në këtë mënyrë gjendjen dhe lëvizjet e asetëve të krahasuara me pasqyrat financiare përkatëse.
- Shoqëria ende nuk ka paraqitur Planin e Investimeve për vitin 2018 me qëllim llogaritjen e RAB.
- Duhet të paraqiten në mënyrë analitike, të grupuara, llogaritjet e amortizimit për vitin 2017.
- Shoqëria nuk ka propozuar një normë të kthimit mbi kapitalin (WACC), në zbatim të formulës për llogaritëse të nenit 10 të *Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*, por paraqet një vlerë fikse të këtij elementi të të ardhurave të kërkuara.
- Aplikimi nuk paraqet një vlerësim mbi konkurrueshmërinë e çmimeve të gazit për klientët fundorë.

Për mungesën e dokumentacionit dhe të dhënave që kanë të bëjnë me parashikimet e *Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*” miratuar me Vendimin nr.178, datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë Albgaz sh.a për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti